

Dalës-izlazo

Nr. X-192
Br.

Data 03.03.2020
Datum

OBILIC-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Drejtoria e Arsimit

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, te Ligji i Punës, nr.03/L -212, neni 5, paragrafi c, Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, neni 35, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, Udhëzimet Administrative të MASHT-it, nr.17/2009, nr.10/2018, e UA nr.07/2017, rregullimi i procedurave në sektorin publik, dhe kërkesën me nr. -X-157, e datës 02.03.2020, Drejtoria e Arsimit me datë 03.03.2020, shpall :

KONKURS

(Për plotësimin e vendeve të punës)

SHFMU" Dr. Ibrahim Rugova" në Obiliq

- ***Vendi i punës: Mësimdhënësi i matematikës***, derisa të kthehet punëtorja nga pushimi mjekësor
- ***Vendi i punës: Mësues klase***, derisa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë

Kushtet për mësimdhënëses :

Kërkohet kualifikimi profesional përkatës, sipas Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ(MASHT), nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional Të Arsimit Të Përgjithshëm.

Kandidatët që konkurojnë për mësimdhënëses duhet ta sjellin kopjen e diplomës së fakultetit të vërtetuar apo noterizuar, vërtetimin për përvojën e punës, certifikatën e lindjes, dokumentin e letërnjoftimit.

Kandidatët, që konkurrojnë për këto vendet e punës, të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët nuk i kanë diplomat e nostifikuar në MASHT nuk do të përfshihen në listën e ngushtë.

Fletëkërkesat merren në Zyrën e Pranimit të KK-së, apo në faqen zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumentet të kompletuara në të njëjtën zyrë. Kandidatët do të ftohen në inervistë përmes telefonit.

Afati i konkursit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtyp dhe te faqja zyrtare e komunës.

Drejtori : Agim Spahiu

